

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "PRO 3 VT" Sh.p.k.

Sot, me datë 15/06/2020

Z. Tarion Balla, shtetas Shqiptar, lindur më 08/05/1978, në Tirane, Shqipëri, mbajtëse i pashaportes me nr:BD3707720, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Z. Endri Ikonomi, shtetas Shqiptar, lindur më 28/02/1976, në Tirane, Shqipëri, mbajtëse leternjoftimit me nr 033138998, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "PRO 3 VT" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Vaso Pasha, Nd.22, H22, AP 4, Njesia Administrative Nr5, 1019 Tiranë, Shqipëri Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies si Institucion Financiar i Mikrokredisë në të gjitha format e saj dhe veprimtarinë për të ofruar shërbimet këshilluese, ndërmjetësuese si dhe shërbime të tjera ndihmëse sipas legjislacionit në fuqi.*

- *Shoqëria mund të lidhë, menaxhojë apo negociojë çdo marrëveshje tjetër lidhur me garantimin e kredive ose kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që siguron të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi e që lidhet drejtpërdrejtë ose terthorazi me objektin e saj.*
- *Shoqëria, me vendim të Administratorit pas miratimit paraprak të asamblesë së përgjithshme, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshem me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj*

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 15,000,000 (Pesëmbëdhjetmilion) leke dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Tarion Balla** , zoteron 1 kuotë, me 70% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 10,500,0000 Leke dhe 10,500,0000 Leke të kapitalit themeltar.
- **Z. Endri Ikonomi**, zoteron 1 kuotë, me 30% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 4,500,000 Leke dhe 4,500,000 Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Z. Tarion Balla** , shtetas Shqiptar, lindur më 08/05/1978 , në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i pashaportes me nr BD3707720 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8


DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Tarion Balla** , shtetas Shqiptar, lindur më 08/05/1978, në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i pashaportes me nr.BD3707720 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Endri Ikonomi



ORTAKËT THEMELUES

Tarion Balla

